



REPUBLIKA E SHqipëRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

SHTOJCA 1

PËR DISA PLOTËSIME NË
UDHËZUESIN
E FILLIMIT TË VITIT SHKOLLOR
2020 - 2021

20
20



Nëntor

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për situatën e pandemisë së shkaktuar nga COVID – 19 dhe në vendimin e Komitetit Teknik të Ekspertëve, MASR në bashkëpunim me ASCAP-in dhe me institucione të tjera të varësisë kanë përgatitur shtojcën 1 të udhëzuesit të fillimit të vitit shkollor 2020 – 2021.

Shkollat, ZVAP-të, DRAP-et dhe DPAP, duke u bazuar në udhëzuesin dhe në këtë shtojcë, si dhe në vendimmarrjet e MASR-së, do të përshtasin mësimin sipas varianteve përkatëse të skenarit 2 që do të zbatohet.

Kujdes: Programi mësimor, plani mësimor dhe ngarkesat mësimore të personelit mësimdhënës nuk do të ndryshojnë në asnjë rast, pavarësisht skenarit të zbatuar sipas kësaj shtojce.

UDHËZIME

PËR SHKOLLAT

- Procesi mësimor sipas skenarit 1, ku mësimi zhvillohet në mjediset fizike të shkollës sipas udhëzuesit të fillimit të vitit shkollor 2020 - 2021, do të vijojë në të gjitha shkollat e përcaktuara nga MASR me propozim të DPAP.
- Me propozim të DPAP dhe miratim të MASR, në shkolla të ndryshme do të zbatohet skenari 2 i udhëzuesit të fillimit të vitit shkollor, i detajuar sipas shtojcës 1. Mësimi i kombinuar sipas shtojcës 1 do të zhvillohet nga data 1 dhjetor 2020 deri në një vendimmarrje tjetër të MASR-së apo të institucioneve të tjera përgjegjëse.
- Gjatë zbatimit të skenarit 2, rekomandohet të zbatohet orari mësimor që shkollat kanë aktualisht. Në raste të përshtatjes më të mirë të punës në shkollë, shkollat kanë fleksibilitetin e ndryshimit të orarit të shkollës në përputhje me nevojat e nxënësve dhe të mësuesve, por pa ndryshuar programin mësimor, planin mësimor dhe ngarkesat mësimore të mësuesve.
- Vlerësimi i nxënësit në skenarin 2 do të bëhet vetëm gjatë kohës që nxënësi është në klasë, sipas udhëzimeve në fuqi.
- Gjatë dy javëve të para të dhjetorit në ditët që nxënësi zhvillon mësimin në mjediset e shkollës, fokusi i mësuesve të jetë më së shumti në testet/detyrat përmbledhëse dhe në vlerësimet e portofolit të nxënësit për periudhën e parë.
-
- Mësuesit e lëndëve të fushave: “Shoqëria dhe mjedisi”, “Arte”, “Teknologji dhe TIK”, “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” etj., NUK zhvillojnë teste, por detyra përmbledhëse me shkrim ose me gojë, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen me teste për të gjitha lëndët.
- Testi/detyra përmbledhëse nuk duhet të jetë i mbingarkuar dhe duhet të synojë vlerësimin çështjeve që nxënësi ka zhvilluar.
- Nxënësit dhe prindërit duhet të jenë të informuar që ditën e premte të çdo jave se si do të zhvillohet mësimi gjatë javës së ardhshme, në mënyrë që të planifikojnë veprimtaritë e tyre.
- Në raste shumë të veçanta kur nxënësi ka raport mjekësor ose me kërkesë të prindërve, nxënësi mund ta zhvillojë mësimin online duke kaluar nga një grup në tjetrin, brenda klasës së tij.
- Nxënësit mund të ndjekin mësimet në RTSH Shkolla sipas orareve që do të publikohen nga MASR.
- Çdo ditë të premte të javës përkatëse, shkollat do të raportojnë në ZVA lidhur me gjendjen e shkollave për zhvillimin e mësimin sipas skenarit 2 shtojca 1, për javën në vijim.

UDHËZIME

PËR ZVA-TË DHE PËR DRAP-ET

- Për secilën shkollë nën juridiksionin e tyre, ZVAP-të dhe DRAP-et çdo ditë të premte të javës përkatëse në bashkëpunim me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe me strukturën përkatëse në këto njësi, propozojnë në DPAP formën e mësimdhënies për javën në vijim, sipas skenarëve të përcaktuar në udhëzuesin e fillimit të vitit shkollor 2020 - 2021 dhe sipas kësaj shtojce.
- DRAP-et dhe ZVA-të të mbështesin shkollat dhe t'i sigurojnë atyre fleksibilitet në zbatimin e skenarit apo variantit të propozuar nga DPAP dhe miratuar nga MASR.
- Çdo ditë të premte të javës përkatëse, DPAP, për secilën shkollë në vend, propozon në MASR, formën e mësimdhënies dhe skenarin apo variantin që do të aplikohet në javën në vijim. Vendimi merret nga MASR dhe përcillet nga DPAP brenda të njëjtës ditë me qëllim njoftimin e nxënësve dhe të prindërve.
- *Shkollat me një turn dhe me numër të vogël nxënësish, publike ose private, në qytet ose në fshat, ku numri i nxënësve nëpër klasa është i vogël dhe nuk ka raste të infektuarish me COVID-19, mund të vazhdojnë të zbatojnë skenarin e parë, siç është sot në fuqi, natyrisht në zbatim të rregullave dhe të protokolleve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik.*

Më poshtë janë përshkruar variantet e skenarit 2, të cilat shkollat do t'i zbatojnë në varësi të kushteve dhe të rrethanave specifike të tyre.

SKENARI 2

Mësimi zhvillohet i kombinuar (në mjediset e shkollës dhe online) sipas varianteve të mëposhtme, duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik.

2.1. Shkollat me një turn dhe me numër të vogël nxënësish, të cilat plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik, në varësi të numrit të nxënësve do të zhvillojnë normalisht procesin mësimor në mjediset fizike të shkollës për klasat e arsimit fillor 1-5 dhe për klasën 12-të të AML.

Klasat e tjera do të zhvillojnë mësimin sipas varianteve si më poshtë:

Varianti A

Klasat 6 – 9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin në javën **tek** dy ditët e para të javës në mjediset e shkollës dhe tri ditët e tjera të javës, online. Në javën **çift** këmbehen dy ditët e para të javës online dhe tri ditët e tjera të javës në shkollë.

Në varësi të situatës së krijuar nga pandemia COVID - 19, në rast se shkollat kanë situata të rënuara në stafet mësimore apo tek nxënësit, me urdhër të MASR (DPAP) mund të vijojnë mësimin me variantet më poshtë:

Varianti B

Klasat 6 – 9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin online.

Varianti C

Klasa e I-rë dhe klasa 12-të do të zhvillojnë mësimin në mjediset fizike të shkollës dhe klasat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 do të zhvillojnë mësimin online.



SKENARI 2

Mësimi zhvillohet i kombinuar (në mjediset e shkollës dhe online) sipas varianteve të mëposhtme, duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik.

2.2. Shkollat me një turn dhe me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmangët grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës;
- ndajnë çdo klasë në dy grupe.

Klasat 1-5 të arsimit fillor dhe klasa e 12-të e arsimit të mesëm të lartë do të zhvillojnë normalisht procesin mësimor në mjediset fizike të shkollës, siç veprohet në skenarin 1 të udhëzuesit për fillimin e vitit shkollor 2020 – 2021.

Klasat 6-9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin sipas varianteve si më poshtë:

Varianti A

Java tek

- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 8.00-11.15, dhe do të zhvillojë *mësim online* gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 12.30-15.45.
- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim online* gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 12.30-15.45, dhe do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës*, gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 8.00-11.15.

Java çift

- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 8.00-11.15, dhe do të zhvillojë *mësim online* gjatë tri ditëve të tjera të javës nga ora 12.30-15.45.
- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim online* gjatë dy ditëve të para të javës nga ora 12.30-15.45, dhe do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë tri ditëve të tjera të javës nga ora 8.00-11.15.

Në varësi të situatës së krijuar nga pandemia COVID - 19, në rast se shkollat kanë situata të rënduara të stafet mësimore apo të nxënësive, me urdhër të MASR- së (DPAP), mund të vijojnë mësimin me variantet më poshtë:

Varianti B

Klasat 6 – 9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin online.

Varianti C

Klasa e 1-rë dhe klasa e 12-të do të zhvillojnë *mësim në mjediset fizike të shkollës*, ndërsa klasat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 do të zhvillojnë *mësim online*.

Mësimi online sipas varianteve B dhe C do të zhvillohet me grupe, siç janë të ndara klasat e nxënësve. Ora e mësimi do të jetë 30 minuta për të gjitha variantet. **Mësimi do të zhvillohet me dy orë të njëpasnjëshme.** Koha mësimore që i shtohet çdo mësuesi është afërsisht 7 orë mësimi në javë, të cilat mund të paguhet si orë suplementare ose këto orë mësimore mund të realizohen me mësues shtesë.

SKENARI 2

Mësimi zhvillohet i kombinuar (në mjediset e shkollës dhe online) sipas varianteve të mëposhtme, duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik.

2.3. Shkollat me dy turne dhe me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik:

2.3.1. Rastet, kur në mjediset fizike zhvillon mësim një shkollë. Këto shkolla:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmangët grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës;
- ndajnë çdo klasë në dy grupe;
- zhvillojnë mësimin me 4 nënturne.

Klasat 1-5 të arsimit fillor dhe klasa e 12-të e arsimit të mesëm të lartë do të zhvillojnë normalisht procesin mësimor në mjediset fizike të shkollës, siç vepohet në skenarin 1 të udhëzuesit për fillimin e vitit shkollor 2020 – 2021.

Turni i parë:

Klasat e tjera 6-9 dhe 10-11 do të zhvillojnë mësimin sipas varianteve si më poshtë:

Varianti A

Java tek

- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 8.00-10.45, dhe do të zhvillojë mësim online gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 11.00-13.45.
- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë mësim online gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 11.00-13.45, dhe do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 8.00-10.45.

Java çift

- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë dy ditëve të para të javës nga ora 8.00-10.45, dhe do të zhvillojë mësim online gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 11.00-13.45.
- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë mësim online gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 11.00-13.45, dhe do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 8.00-10.45.

Në varësi të situatës së krijuar nga pandemia COVID - 19, në rast se shkollat kanë situata të rënduara në stafet mësimore apo tek nxënësit, me urdhër të MASR (DPAP) mund të vijojnë mësimin me variantet më poshtë:

Varianti B

Klasat 6 - 9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin online.

Varianti C

Klasa e 1-rë dhe klasa e 12-të do të zhvillojnë mësim në mjediset fizike të shkollës, ndërsa klasat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 do të zhvillojnë mësim online.

Turni i dytë:

Klasat 6 -9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin sipas varianteve si më poshtë:

Varianti A

Java tek

- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 14.00-16.45, dhe do të zhvillojë *mësim online* gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 17.00-19.45.
- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim online* gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 17.00-19.45, dhe do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 14.00-16.45.

Java çift

- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 14.00-16.45, dhe do të zhvillojë *mësim online* gjatë tri ditëve të tjera, nga ora 17.00-19.45.
- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim online* gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 17.00-19.45, dhe do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 14.00-16.45.

Në varësi të situatës së krijuar nga pandemia COVID - 19, në rast se shkollat kanë situata të rënduara të stafet mësimore apo të nxënësive, me urdhër të MASR –së (DPAP) mund të vijojnë mësimin me variantet më poshtë:

Varianti B

Klasat 6 – 9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin online.

Varianti C

Klasa e 1-rë dhe klasa 12-të do të zhvillojnë mësim në mjediset fizike të shkollës, ndërsa klasat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 do të zhvillojnë mësim online.

Në këtë rast, nëse mësuesit që japin mësim në të dyja turnet, nuk janë të njëjtët atëherë oraret e nënturneve të dyta mund të afrohen.

Mësimi online sipas varianteve B dhe C do të zhvillohet me grupe, siç janë të ndara klasat e nxënësve. Ora e mësimit do të jetë 25 minuta për të gjitha variantet. ***Mësimi do të zhvillohet me dy orë të njëpasnjëshme.*** Koha mësimore që i shtohet çdo mësuesi është afërsisht 2-3 orë mësimi në javë, të cilat mund të paguhen si orë suplementare ose këto orë mësimore mund të realizohen me mësues shtesë.

SKENARI 2

Mësimi zhvillohet i kombinuar (në mjediset e shkollës dhe online) sipas varianteve të mëposhtme, duke ruajtur të gjitha rregullat e higjienës dhe të distancimit fizik.

2.3. Shkollat me dy turne dhe me numër të madh nxënësish, të cilat në mënyrën normale të funksionimit të tyre nuk plotësojnë protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për higjienën dhe për distancimin fizik:

2.3.2. Rastet, kur në mjediset fizike zhvillojnë mësim dy shkolla. Këto shkolla:

- ndërtojnë një grafik për hyrjen dhe për daljen e nxënësve që të shmangët grumbullimi i tyre, pa prekur orën e fillimit dhe të mbarimit të shkollës;
- ndajnë çdo klasë në dy grupe.

Klasat 1-5 të arsimit fillor dhe klasa e 12-të e arsimit të mesëm të lartë do të zhvillojnë normalisht procesin mësimor në mjediset fizike të shkollës, siç vepohet në skenarin 1 të udhëzuesit për fillimin e vitit shkollor 2020 – 2021.

Shkolla e parë e zhvillon mësimin gjatë turnit të parë, me dy nënturne

Klasat 6-9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin sipas varianteve si më poshtë:

Varianti A

Java tek

- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 8.00-10.45, dhe do të zhvillojë mësim online gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 11.00-13.45.
- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë mësim online gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 11.00-13.45, dhe do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 8.00-10.45.

Java çift

- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 8.00-10.45, dhe do të zhvillojë mësim online gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 11.00-13.45.
- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë mësim online gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 11.00-13.45, dhe do të zhvillojë mësim në mjediset fizike të shkollës gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 8.00-10.45.

Në varësi të situatës së krijuar nga pandemia COVID - 19, në rast se shkollat kanë situata të rënduara te stafet mësimore apo te nxënësit, me urdhër të MASR-së (DPAP) mund të vijojnë mësimin me variantet më poshtë:

Varianti B

Klasat 6 – 9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësim online.

Varianti C

Klasa e I-rë e arsimit fillor dhe klasa 12-të e arsimit të mesëm të lartë do të zhvillojnë mësim në mjediset fizike të shkollës, ndërsa klasat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 do të zhvillojnë mësim online.

Shkolla e dytë e zhvillon mësimin gjatë turnit të dytë, me dy nënturne:

Klasat 6-9 dhe 10-11 do të zhvillojnë mësimin sipas varianteve si më poshtë:

Varianti A

Java tek

- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë dy ditëve të para të javës nga ora 14.00-16.45, dhe do të zhvillojë *mësim online* gjatë tri ditëve të tjera të javës nga ora 17.00-19.45.
- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim online* gjatë dy ditëve të para të javës nga ora 17.00-19.45, dhe do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë tri ditëve të tjera të javës nga ora 14.00-16.45.

Java çift

- **Grupi i dytë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë dy ditëve të para të javës nga ora 14.00-16.45, dhe do të zhvillojë *mësim online* gjatë tri ditëve të tjera të javës nga ora 17.00-19.45.
- **Grupi i parë** i çdo klase do të zhvillojë *mësim online* gjatë dy ditëve të para të javës, nga ora 17.00-19.45, dhe do të zhvillojë *mësim në mjediset fizike të shkollës* gjatë tri ditëve të tjera të javës, nga ora 14.00-16.45.

Në varësi të situatës së krijuar nga pandemia COVID - 19, në rast se shkollat kanë situata të rënduara në stafet mësimore apo tek nxënësit, me urdhër të MASR (DPAP) mund të vijojnë mësimin me variantet më poshtë:

Varianti B

Klasat 6 – 9 dhe klasat 10-11 do të zhvillojnë mësimin online.

Varianti C

Klasa e I-rë e arsimit fillor dhe klasa e 12-të e arsimit të mesëm të lartë do të zhvillojnë mësim në mjediset fizike të shkollës, ndërsa klasat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 do të zhvillojnë mësimin online.

Mësimi online sipas varianteve B dhe C do të zhvillohet me grupe siç janë të ndara klasat e nxënësve. Ora e mësimi do të jetë 25 minuta për të gjitha variantet. **Mësimi do të zhvillohet me dy orë të njëpasnjëshme.** Koha mësimore që i shtohet çdo mësuesi është afërsisht 2-3 orë mësimi në javë, të cilat mund të paguhen si orë suplementare ose këto orë mësimore mund të realizohen me mësues shtesë.

Kujdes:



Kalimi në skenarin 3 të udhëzuesit të fillimit të vitit shkollor 2020-2021 bëhet me miratimin e MASR-së, pas vlerësimit të situatës epidemiologjike në vend nga strukturat kompetente dhe vendimin përkatës të MSHMS-së.



Përcaktimet e udhëzuesit të fillimit të vitit shkollor 2020-2021 dhe të kësaj shtojce janë të vlefshme edhe për institucionet arsimore private, të cilat trajtohen nga ZVAP, DRAP dhe DPAP, njësoj si për shkollat publike.



www.ascap.edu.al
Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tirana
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR